



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:113753
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05565011

E.nr.822/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Z.H. nga Shtimja, të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të procedurës si dhe shpërblimin jubilar, më datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.822/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.822/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Komuna e Shtimes - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpenzimeve të procedurës, si dhe shpërblimi jubilar në bazë të aktgjykimit C.nr.1318/21, të datës 23.12.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1.318.34 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.822/23, më datë 11.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi